



DITARI MUJOR

GUSHT 2025



Një fushë futbollit dhe një pistë e re atletike për Universitetin e Sporteve
Muaji nëntor do të shënojë mbylljen e punimeve për rindërtimin e pistës së atletikës dhe fushës së futbollit në Universitetin e Sporteve të Tiranës. Një investim prej rreth 145 milionë lekësh, që do t'u shërbejë rreth 2,000 studentëve të UST-së, 195 pedagogëve, sportistëve elitare, por edhe të gjithë të rinjve që duan të ushtrohen disiplina të ndryshme sportive (kërcim së gjati, kërcim së larti, kërcim me shkop, hedhje gjyle, hedhje shtize, hedhje çekiçi). Kjo fushë do t'i shërbejë edhe komunitetit lokal dhe do të nxisë interesimin e të rinjve për sportin.



Diaspora, 27 mijë tekste për të mësuar gjuhën dhe kulturën shqiptare

Mbi 27 mijë tekste po shpërndahen për nxënësit e shkollave dhe klasave të gjuhës shqipe në diasporë, anembanë botës. Një shifër 70% më e lartë se një vit më parë. Edhe për vitin shkollor 2025-2026 janë plotësuar të gjitha kërkesat e ardhura nga përfaqësitë dhe ambasadat dhe janë marrë masat që këtë vit i gjithë procesi të përfundojë brenda muajit gusht dhe nxënësit të kenë tekstet para fillimit të vitit shkollor. Për të gjithë ata që nuk kanë mundur të bëjnë kërkesat në kohë apo që hapin klasa në mes të vitit, Qendra e Botimeve të Diasporës vë në dispozicion tashmë disa lloje tekstesh për mësimin e gjuhës shqipe, të hartuara në bashkëpunim me Fakultetin Filologjik të Tiranës. Gjithashtu vë në dispozicion, të shkarkueshme, mbi 50 tituj librash dygjuhësh në ndihmë të mësimdhënies në diasporë.

Tekstet falas, 236 mijë nxënës po pajisen me libra

Nisi shpërndarja e teksteve falas për nxënësit e arsim-it parauniversitar. Mbi 236 mijë nxënës të arsimit bazë dhe kategori në nevojë të arsimit të mesëm po pajisen me tekste shkollore falas, me financim nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, me një fond prej 9 milionë eurosh. Shpërndarja e teksteve për vitin shkollor 2025-2026 ka nisur që prej datës 25 gusht 2025, në vijim të politikës mbështetëse të qeverisë për familjet, për t'u ardhur në ndihmë familjeve shqiptare, më së shumti atyre me burime të kufizuara financiare dhe atyre që përballen me vështirësi ekonomike, për të minimizuar koston e edukimit të fëmijëve të tyre. Deri në fillim të vitit të ri shkollor, të gjithë nxënësit e 9-vjeçares dhe kategoritë në nevojë do të jenë të pajisur me tekstet mësimore




Viti i ri me shkolla të reja, hapin dyert 30 institucione të rehabilituara



Më 8 shtator, në ditën e parë të shkollës, do të hapin dyert 30 shkolla të reja, të rehabilituara, të cilat do të mirëpresin mbi 8 mijë nxënës dhe mësues me kushte dinjitoze, klasa të reja, laboratorë, terrene sportive, palestra e hapësira rekreative. Falë investimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe pushtetit lokal do të jenë gati për ditën e parë të shkollës institucionet arsimore "Dëshmorët e Peshkëpisë" në Selenicë, shkolla "Ndre Mjeda" në Shkodër, shkolla "Gaqi Karakashi" në Kuçovë, shkolla 9-vjeçare "Rilindja" në Gramsh, "Angela Merkel" në Bashkinë Kamzë, shkolla 9-vjeçare "Besëlidhja e Malësisë" në Bajram Curri, shkolla e bashkuar "Muhamet Gjollësja" në Lazarat, gjimnazi "Jani Nushi" në Lushnjë, "Meleq Gosnishti" në Përmet e shumë të tjera. Përmirësimi i infrastrukturës mësimore dhe sportive për të rritur standardet e sistemit tonë arsimor, për t'u ardhur në ndihmë mësuesve dhe nxënësve; për të rritur performancën dhe rezultatet, është një nga prioritetet e qeverisë shqiptare. Me një fond prej 4,2 miliardë lekësh, 40 objekte të reja mësimore dhe sportive, mes të cilave 22 shkolla të reja dhe 18 palestra dhe terrene sportive do t'i nënshtrohen procesit të rindërtimit dhe rikonstruksionit përgjatë viteve 2025-2026.

NISËN REGJISTRIMET PËR STUDENTËT E RINJ NË UNIVERSITETET TONA

Nga data 29 gusht deri në 11 shtator 2025 do të kryhen regjistrimet e të rinjve, për të ndjekur studimet në universitetet tona. Rreth 20,200 maturantë aplikuan në fazën e parë për të ndjekur studimet e larta, duke shënuar një numër më të lartë se një vit më parë. Viti i ri akademik 2025-2026 do të nisë me një ofertë akademike më të pasur, me një infrastrukturë mësimore dhe laboratorike të një niveli më të lartë, duke rritur standardet dhe duke tërhequr vëmendjen e më shumë të rinjve drejt institucioneve tona.



KURRIKULA TË REJA PËR AFTËSIMIN DIGJITAL TË NXËNËSVE

Këtë vit të ri shkollor, për herë të parë, nxënësit e klasës së katërt do të mësojnë bazat e inteligjencës artificiale, me kurrikulën e re të TIK-ut, teksa vijojnë investimet për zgjerimin e rrjetit të laboratorëve inteligjentë në shkolla. Brenda vitit 2027 numri i laboratorëve inteligjentë do të shkojë në 1 mijë, duke pajisur çdo shkollë me smartlabë dhe duke krijuar akses të barabartë për çdo nxënës të arsimit parauniversitar në teknologjinë digjitale. Krahas kurrikulës së TIK-ut, të gjitha kurrikulat mësimore po kalojnë përmes procesit të rishikimit dhe modernizimit, sipas kërkesave të shek. XXI.